

03-04-2020				REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVA KOMUNA -SUHAREKËS OPSTINE SUVA REKA THE MUNICIPALITY OF SUHAREKA			
MARË NË DORËZIM - PRILJENO - RECEIVED							
Nësia org. Org. Jedinica Org. Unit	Numri Broj Number	Shtesa Prilog Appendix	Vlera Vrednost Value	KONTRATË PUBLIKE KORNIZE			
01	351	16291	£				

KOMUNA SUHAREKË, të cilën e përfaqëson Mustafë Buzhala , zyrtar i zyrës së Prokurimit dhe menaxheri i kontratës te caktuar me Aktvendim nga ZKA dhe në PMK (në vazhdim "Autoriteti Kontraktues"), në njërën anë dhe

KRM "EKOREGJIONI" SH.A me seli ne Prizren me NUI 888324152 të cilën e përfaqëson Nehat Basha (ne vazhdim "ofruesi i Sherbimeve"), ne anën tjetër, janë pajtuar te lidhin një kontrate publike për shërbimet e shënuara me poshtë:

MIRËMBAJTJA DHE PASTRIMI I QYTETIT

me numër prokurimit: 624 -20-011- 215 / 624-20-802-215

Neni 1 Lënda

1.1 Lënda e kontrates publike kornizë është të krijoj kushtet, duke përfshirë çmimet dhe rregullat e implementimit për kryerje të shërbimeve në vijim: **MIRËMBAJTJA DHE PASTRIMI I QYTETIT, sipas specifikimeve teknike te dosjes se tenderit.**

1.2 Kontrata publike kornizë do të implementohet me "vendosjen e porosive" apo thirrje. P.sh. Kurdo që Autoriteti Kontraktues, tenton të blejë shërbime në bazë të kësaj kontrate publike kornizë, duhet që të dërgojë "porosinë" tek ofruesi i shërbimeve, duke specifikuar listën me shërbimet dhe sasi të tyre përkatëse.

1.3 Sasi të e vlerësuar, të përcaktuara në Pjesën C, Pershkrimi i Çmimeve, janë vetëm sasi indikative. Autoriteti(et) Kontraktues i përmendur në Nenin 1.1 është (janë) i/të detyruar të përdorë/in këtë marrëveshje kornizë sa herë që të prokurojnë shërbimet e përmendura në 1.1.

1.4 Ekzekutimi i Kontrata fillon me datë 03/04/2020 dhe përfundon në datën 02/04/2021.

Neni 2 Koha e përfundimit

2.1 Afati kohor për kryerje të shërbimeve do të jetë 1 ditë (24h) nga koha e lëshimit të urdhër blerjes nga ana e Autoritetit Kontraktues.

2.2 Vendi i kryerjes se shërbimeve do të jetë: Teritori i Komunes Suharekë, përfshire rruget, parqet dhe hapësirat siq është specifikuar ne dosje.

Neni 3 Çmimi

3.1 Çmimet njësi të shërbimeve janë paraqitur në Ofertën Financiare, Lista e Çmimit e paraqitur nga ofruesi i shërbimeve.

Vlera indikative vjetore e kontratës është **137.066,42€ (njëqindë e tridhjetë e shtatë mijë e gjashtëdhjetë e gjashtë euro e katërdhjetë e dy cent).**

3.3 Derivimi i lejuar nga vlera totale indikative nuk mundet të jete më e lartë se sa përqindja e percaktuar konform nenit 38 pika 2 të LPP-së.

3.4 Çmimi i përmendur në Nenin 3.1 më sipër duhet të jetë e vetmja pagesë që Autoriteti Kontraktues i ka borxh Furnizuesit sipas kontratës publike kornizë.

3.5 Çmimet për njësi janë fikse dhe nuk do të nënshtrohen ndryshimeve për porositë e vendosura nën këtë kontratë kornizë.

3.6 Autoriteti Kontraktues do të bëjë pagësen në euro, sipas faturave mujore të dorëzuara nga OE së bashku me raportin e nënshkruar nga organi mbikëqyrësi dhe menaxheri i kontratës nga njësia e kërkesës, në llogarinë bankare të OE.

Neni 4 Rendi i përparësisë së dokumenteve të kontratës

4.1 Kontrata përbëhet nga dokumentet në vijim:

- (a) Kontrata Publike Kornizë;
- (b) Kushtet e Veçanta të Kontratës;
- (c) Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
- (d) Tenderi i Furnizuesit, duke përfshirë Specifikimet Teknike;
- (e) Oferta financiare (Lista e Çmimeve);
- (f) Urdhër blerja;
- (g) *[shëno çdo dispozitë tjetër të dosjes së tenderit].*

4.2 Dokumentet e ndryshme që e përbëjnë kontratën konsiderohet se shpjegojnë njëra tjetrën; dhe në raste të paqartësisë ose divergjencës, ato duhet të lexohen sipas rendit të përparësisë në të cilin janë dhënë më sipër.

Neni 5 Komunikimet

5.1 Të gjitha komunikimet me shkrim që kanë të bëjnë me këtë Kontratë ndërmjet Autoritetit Kontraktues, nga njëra anë dhe Furnizuesit nga ana tjetër duhet të cekin titullin e Kontratës dhe numrin e saj të identifikimit dhe duhet të dërgohen me postë, faks, email ose të dorëzohen personalisht.

5.2 Nëse personi që dërgon komunikatën kërkon vërtetim të pranimit të saj, ai duhet ta thotë këtë në komunikatën e tij. Sa herë që ka afat të fundit për pranimin e komunikatës me shkrim, dërguesi duhet të kërkojë vërtetim të pranimit të komunikatës së tij. Në të gjitha rastet, dërguesi duhet t'i marrë të gjitha masat e nevojshme për të siguruar pranimin e komunikimit të tij.

5.3 Kudo që në kontratë parashikohet dhënia e ndonjë njoftimi, pëlqimi, miratimi, certifikate, ose vendimi, përveç nëse specifikohet ndryshe në njoftimin e tillë, pëlqim, miratim, certifikatë apo vendim do të jetë në formë të shkruar dhe fjalët "njoftoj", "vërtetojë", "miratoj" ose "vendosë" do të shenohen në përputhje me rrethanat. Ndonjë miratim, pajtim, certifikatë ose vendimi i tillë nuk duhet të mbahet apo vonohet pa arsye.

5.4 Kjo kontratë është përgatitur në gjuhë Shqipe në tri origjinale, dy origjinale për Autoritetin Kontraktues dhe një origjinal për Furnizuesin.

- 5.5 Kontrata menaxhohet nga njësitë e kërkesës të percaktuar me vendim të ZKA-së dhe me PMK¹ 2.
- 5.6 Menaxheri i kontratës i është obliguar që pas plotësimit dhe nënshkrimit të PMK-së me OE të njëjtin mbrenda dy ditë ta dorëzojë në ZP.
- 5.7 Numri i kontaktit me OE është: 029271688 dhe **044229181**

Për Autoritetin Kontraktues:

Emri:	Mustafë Buzhala
Pozita:	Zyrtar i zyres se Prokurimit
Nënshkrimi:	
Data:	03/04/2020



Për ofruesin e shërbimeve:

Emri:	Nehat Basha
Pozita:	Përfaqësues
Nënshkrimi	
Data:	03/04/2020



Emri:	Bali Muharremaj
Pozita:	Zyrtar Kryesor Administrativ / Kryetar Komuna Suhareke
Nënshkrimi:	
Data:	
Vula:	03/04/2020



¹ PMK Plani i Menaxhimit të Kontratës

² ZKA Zyrtari Kryesor Administrativ

KUSHTET E VEÇANTA

KVK në vijim do të plotësojnë dhe/ose ndryshojnë KPK. Sa herë që ka një konflikt, dispozitat këtu do të mbizotërojnë mbi ato të KPK.

Kushtet e Përgjithshme të Kontratës		Amandamentimet/Modifikimi i Nenit përkatës në KPK
Përshkrimi i nenit	Nr. Nenit	MIRËMBAJTJA DHE PASTRIMI I QYTETIT NR i prokurimit: 624 -20-011- 215 / 624-20-802-215
Ligji zbatueshëm dhe gjuha	2.1	Ligjet e Kosovës që janë në fuqi do të zbatohen për të gjitha çështjet që nuk mbulohen nga dispozitat e kontratës. Juridiksioni do të jetë gjykata përkatëse në Prishtinë.
	2.2	Gjuha e përdorur do të jetë gjuha Shqipe .
Fillimi dhe Përfundimi i shërbimeve	6.1	Data e Fillimit të fillimit të furnizimeve është: Medatë 03.04.2020
	6.4	Data e Përfundimit është me dat 02.04.2021
	6.5	Vendi i kryerjes së shërbimeve është në teritorin e <i>Komunës Suharekë sipas specifikimeve teknike</i>
Obligimet e Autoritetit Kontraktues	12.3	Menaxheri i Projektit është : nga Njësija e kërkesës sipas vendimit te ZKA-se.
Dëmet e likuiduara	13.1	Norma e dëmeve të likuiduara është 0.25% e Çmimit final të Kontratës në ditë. Shuma maksimale e dëmeve të likuiduara për tërë kontratën është 10% të çmimit final të kontratës.
Siguria e ekzekutimit	14.1	Shume e Sigurisë së Ekzekutimit është 10% i vlerës se kontratës me vlefshmëri prej 13 muaj.

Sigurimi që do të merret nga ofruesi i shërbimeve	15.1	Shuma minimale e sigurimit do të jetë: (a) Nëse ndodh ndonjë humbje apo dëmtim lidhur me punët, ndonjë pjesë të tyre, materialet apo impiantin gjatë periudhës mbi të cilën kontraktuesi është përgjegjës për përkujdesjen e tyre, për çfarëdo arsye, përpos rreziqeve të definuara sipas nenit 38 të KPK, kontraktuesi korrigjon humbjen apo dëmtimin e tillë nën shpenzimet e veta, në mënyrë që punët e përhershme në çdo aspekt të jenë në përputhje me dispozitat e kontratës sipas kërkesave të menaxherit të kontratës. Kontraktuesi siguron punët, së bashku me materialin dhe impiantin gjer në koston e zëvendësimit të plotë; (b) Nëse ndodh ndonjë humbje apo dëmtim i Pajisjeve një shumë e cila është e mjaftueshme për zëvendësimin e tyre; (c) Nëse ndodh ndonjë humbje apo dëmtim i pronës (përveç Punëve, Impianteve, Materialeve dhe Pajisjeve) në lidhje me Kontratën shuma minimale është 15.000 euro për çdo ndodhi, kurse numri i ndodhive është i pakufizuar. (d) Nëse ndodh ndonjë dëmtim personal ose vdekje: (i) e punëtorëve të Kontraktuesit: 50.000 euro për çdo ndodhi, kurse numri i ndodhive është i pakufizuar a) e personave të tjerë: 50.000 euro për çdo ndodhi, kurse numri i ndodhive është i pakufizuar
Parimet e përgjithshme të pagesës	16.1	Pagesa do të bëhet nga ana e Autoritetit Kontraktues për shërbimet e kryera vetëm në bazë të shumës së vlerës së një Urdhër Blerje të vlefshme të lëshuar nga autoriteti kontraktues
Kontrolli i kualitetit	17.1	Parimi dhe modalitetet e Inspektimit të Shërbimeve nga Autoriteti kontraktues do të jenë si në vijim: sipas kërkesave të njesise Periudha Garantuese e Defekteve është: 3 dite
Zgjidhja miqësore e	20.2	ZP Komuna Suhareke ose Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik – Divizioni i rregullave.

mosmarrëveshjes		
Zgjidhja e mosmarrëveshjes me procedure gjyqësore	21.1	a) Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit të kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet Gjykatën Themelore-Prishtinë në pajtim me ligjin në Kosovë.

Pastrimi dhe mirembajtja e rrugeve, trotuarve, shesheve dhe hapsirave publike ne Komunen e Suharekës

PARAMASA ME PARALLOGARI					
Nr.	Pozicioni	Njësia	Sasia	Cmimi njësi €	Cmimi total €
INCIZIMET DHE PUNËT PARAPRAKE NË TEREN					
1.0	Mirembajtja dhe pastrimi i rrugeve lokale dhe trotuareve duke bere fshirjen dhe pastrimin e tyre nga mbeturinat, pluhuri dhe gjesendet tjera. Pastrimi te behet nje here ne jave minimum qe nenkupton se e njejta rruge duhet te pastrohet 4 her minimum ne muaj e pastaj faturohet ne baza mujore. Mirembajtja dhe pastrimi behet gjithmone sipas planit dhe pelqimit nga AK. Llogaria ne baza mujore. Ky pozicion vlene per te gjitha fshatrat dhe qytetin e Suharekes.	m ¹	247,572.00	0.18	44562.96
2.0	Larja e rrugeve lokale dhe trotuareve duke bere larjen e tyre nga mbeturinat, pluhuri dhe gjesendet tjera. Larja te behet nje here ne jave minimum qe nenkupton se e njejta rruge duhet te lahet 4 her minimum ne muaj e pastaj faturohet ne baza mujore. Larja behet gjithmone naten per shkak te pengesave ne komunikacion, gjithmone sipas planit dhe pelqimit nga AK. Llogaria ne baza mujore. Ky pozicion vlene per te gjitha fshatrat dhe qytetin e Suharekes.	m ¹	144,417.00	0.12	17330.04
3.0	Mirembajtja dhe pastrimi i shesheve, parqeve, shtigjeve te ecjes dhe lapidarëve, duke bere fshirjen dhe pastrimin e tyre nga mbeturinat, pluhuri dhe gjesendet tjera. Pastrimi te behet nje here ne jave minimum qe nenkupton se e njejta duhet te pastrohet 4 her minimum ne muaj e pastaj faturohet ne baza mujore. Mirembajtja dhe pastrimi behet gjithmone sipas planit dhe pelqimit nga AK. Llogaria ne baza mujore. Ky pozicion vlene per te gjitha fshatrat dhe qytetin e Suharekes.	m ²	151,350.00	0.07	10594.50
4.0	Pastrimi dhe mirembajtja e gjelbrimit ne varreza, duke perfshire kositjen e barit, prerjen dhe largimi i vegjetacionit te ulet dhe te larte ne siperfaqet e varrezave. Ne qmim te llogariten te gjitha punet, materiali hargjues, pajisjet per pune, makineria si dhe ngarkimi dhe transporti i drunjeve dhe mbeturinave tjera ne deponin me te aferte ku e percakton AK. Pastrimi dhe kositja te behet dy here ne muaj minimum qe nenkupton se e njejta hapsire duhet te pastrohet dhe kositet 2 her minimum ne muaj e pastaj faturohet ne baza mujore. Mirembajtja dhe pastrimi behet gjithmone sipas planit dhe pelqimit nga AK. Llogaria ne baza mujore. Ky pozicion vlene per te gjitha fshatrat dhe qytetin e Suharekes.	m ²	220,000.00	0.07	15400.00



5.0	Mirembajtja e gjelbrimit ne parqe, sheshe, shtigje te ecjes dhe pergjate brezit rrugor, duke perfshire kositten e barit, prerjen dhe largimi i vegjetacionit te ulet dhe te larte ne siperfaqet e shesheve dhe ne brezin e rruges ne distance 1-5 m prej skajit te rruges. Ne qmim te llogariten te gjitha punet, materiali hargjues, pajisjet per pune, makineria si dhe ngarkimi dhe transporti i drunjeve dhe mbeturinave tjera ne deponin me te aferte ku e percakton AK. Pastrimi, kosijtja e barit, prerja dhe largimi i vegjetacionit te ulet dhe te larte te behet dy here ne muaj minimum qe nenkupton se e njejta hapsire duhet te mirembahet (pastrohet, kositet dhe prerjet e vegjetacionit te ulet dhe te larte) 2 her minimum ne muaj e pastaj faturohet ne baza mujore. Mirembajtja dhe pastrimi behet gjithmone sipas planit dhe pelqimit nga AK. Llogaria ne baza mujore. Ky pozicion vlene per te gjitha fshatrat dhe qytetin e Suharekes.	m ²	288,620.00	0.06	17317.20	✓
6.0	Ujtyja e hapsirave te gjelbrimit, luleve dhe drunjeve dekorativ ne te gjitha hapsirat publike. Ne qmim: te llogariten te gjitha punet, materiali hargjues, pajisjet per pune si dhe makineria per ujtyje. Ujityja te behet gjithmone sipas kerkeses nga AK. Llogaria per m2 te siperfaqes se ujitur. Ky pozicion vlene per te gjitha fshatrat dhe qytetin e Suharekes.	m ²	25,540.00	0.09	2298.60	✓
7.0	Mirembajtja dhe pastrimi i shtratit te lumit ne zonen urbane, duke bere pastrimin e mbeturinave inerte dhe gjesendev tjera qe gjenden ne shtrat te lumit. Pastrimi te behet sipas kerkeses se AK. Llogaria per meter gjatesi te shtratit te lumit dhe per qdo pastrim te kryer te shtratit te lumit, ashtu qe punekryesi do te faturoj aq here sa pastron shtratin e lumit.	m ³	4,000.00	1.51	6040.00	✓
8.0	Mirembajtja dhe pastrimi i hapsirave publike (te perbashketa) ne objektet shumebanesore. Me kete pozicion duhet bere fshirjen dhe pastrimin nga mbeturinat, pluhuri dhe gjesendet tjera te hyrjeve te objekteve, shkalleve, koridoreve te perbashketa, liftave dhe hapesirave per shume qellime, po ashtu duhet qe te behet edhe larja e xhamave ne hapsirat e lartecekura. Pastrimi dhe mirembajtja te behet nje here ne jave apo minimum 4 here ne muaj. Faturoimi behet ne baza mujore. Ne qmim te llogariten materiali hargjues dhe pajisjet per pune.	cope	384.00	52.00	19968.00	✓
9.0	Largimi i mbeturinave shtezore (kafshet e ngordhura) nga rruget lokale, trotuaret, sheshet, Varrezat, shtigjet ecjes dhe te gjitha hapsirat tjera publike ku konstaton AK. Me kete pozicion perfshihen largimi, transporti, dezinfektimi dhe vorrosja e tyre. Llogaria behet per cope te kafshëve te ngordhura	cope	240.00	1.00	240.00	✓
10.0	Largimi dhe transporti i mbeturinave te mobiljeve shtepiake duke perfshire mobiljet me pajisje peregjellese. Llogaria per ton te materialit te ngarkuar. Mbledhja dhe transporti i kesaj mbeturine behet 4 here ne vit dhe faturohet per qdo mbledhje te tyre ne ton.	ton	356.00	3.02	1075.12	✓
11.0	Pastrimi i rrugeve lokale, trotuarve dhe shesheve nga bora gjate stines se dimrit me dore apo makineri perkatese. Pastrimi behet gjithmone me urdher te AK. Llogaria per m2 te trotuarit te pastruar nga bora.	m ²	112,000.00	0.02	2240.00	✓
Gjithsej I.I:					137065.42	✓

Verejtje: u

Totali i sherbimeve per 12 muaj do te jete 137,067.00 €

